

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2013

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore
04.04.2013		18,620.00	1,900.00
11.04.2013		15,000.00	2,000.00
18.04.2013		16,600.00	2,750.00
22.04.2013	1,600.00		
23.04.2013	4,000.00		
25.04.2013		17,700.00	1,950.00
02.05.2013		13,000.00	2,000.00
09.05.2013		12,530.00	2,000.00
16.05.2013		20,490.00	1,880.00
23.05.2013		14,380.00	2,650.00
30.05.2013		11,490.00	1,980.00
06.06.2013		7,040.00	700.00
13.06.2013		9,180.00	700.00
20.06.2013	750.00	14,380.00	2,000.00
21.06.2013	3,220.00		
27.06.2013		14,190.00	2,000.00

Ndërhyrjet në tregun e parasë, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar është rritur nga mesatarisht nga 16.93 miliardë lekë në tremujorin e parë, në mesatarisht 18.81 miliardë lekë në tremujorin e dytë të vitit 2013. **Në ndryshim nga tremujori i parë kur ecuria pozitive e likuiditetit të sistemit u ndikua nga hyrja e lartë e cash-it, për rreth 6.6 mld lekë, në tremujorin e dytë daljet e cash-it prej 12 mld lekësh ndikuan në uljen e likuiditetit të sistemit, duke bërë të nevojshme rritjen e injektimit nga Banka e Shqipërisë.**

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 14.20 miliardë lekë në javë*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë riblerje me maturim njëmujor, mesatarisht 1.88 miliardë lekë në javë*.

Me qëllim korrigjimin e sasisë së likuiditetit në sistem për shkak të devijimit në kahun negativ të faktorëve autonomë, në datat 22.04.2013 dhe 23.04.2013, që

përkonin me ditët e fundit të mbajtjes së rezervës së detyruar, u zhvilluan ankandet reverse repo njëditor. me shumë të shpallur respektivisht 1.60 mld lekë dhe 4.00 mld lekë.

Injektimet njëditore në datat 20.06.2013 dhe 21.06.2013, mundësuan mbylljen e periudhës së rezervës me tepricë mesatare pozitive, duke korrigjuar mungesën në sistem të shkaktuar prej mosplotësimit të ankandëve injektuese në javën e mëparshme, shoqëruar kjo me mbikërkesë në ankandin reverse repo njëmujor të datës 20.06.2013 dhe mosplotësim të shumës për injektim në ankandin reverse repo njëjavor të së njëjtës datë.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013, depozita njëditore u përdor në total në 28 raste, mesatarisht 1.98 miliardë lekë, ndërkohë që në tremujorin e kaluar ky instrument është përdorur në 45 raste, duke regjistruar një mesatare për rreth 1.39 miliardë lekë. Përdorimi i depozitës njëditore është përqendruar kryesisht në javët 16-23 maj dhe 13-27 qershor. Akumulimi i tepricës së likuiditetit në fund të periudhës së mbajtjes së rezervës, çoi në përdorim të rregullt të depozitës o/n gjatë javës 16- 23 maj 2013, mesatarisht nga 6 banka në ditë, ndërkohë që në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës, depozita u përdor nga 12 banka.


Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 4 raste, mesatarisht 2.02 miliardë lekë, përqendruar në datat 22-23 prill dhe 20-21 qershor, paralelisht me injektimet njëditore të zhvilluara nga BSh-ja në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar. Gjatë tremujorit të parë të vitit, ky instrument u përdor në 8 raste, mesatarisht 1.47 miliardë lekë.

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2013.


Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, në periudhën 2011-2013 (me çmim blerjeje).



2. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2013

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013, Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e pranishme në tregun valutor.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2013

Gjatë këtij tremujori, Banka e Shqipërisë ka blerë nga Ministria e Financave në mënyrë të përhershme 50 milionë euro. Edhe gjatë tremujorit të dytë ka vijuar lidhja e kontratave *swap* nëpërmjet blerjes së valutës *spot* dhe shitjes në të ardhmen me afate maturimi një javë – dy muaj midis BSh-së dhe MF-së, nxitur nga nevoja e menaxhimit të likuiditeteve të kësaj të fundit. Blerjet e valutës së BSh-së nga MF-ja në kuadër të marrëveshjeve *swap*, gjatë kësaj periudhe qenë 22,979.27 milionë lekë, ndërsa shitjet 23,058.25 milionë lekë. Në fund të tremujorit, vlera e kontratave *swap* të pamaturuara qe 8,792.8 milionë lekë, kundrejt 981.3 milionë lekë që rezultonte në fund të tremujorit të parë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 181.11 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE (SWAP)	22,979.27	23,058.25
TË TJERA (IDA, IBRD)	181.11	